



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/26
Datë: 16.08.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 80 të Ligjit Nr. 06/L-026 për Azil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës e vlerëson të nevojshëm ofrimin e mbrojtjes së përkohshme e të menjëhershme personave të rrezikuar nga konflikti i brendshëm në Afganistan.
2. Personat, subjekt i ndihmës nga pika 1. e këtij vendimi, janë personat në proces të aplikimit për Special Immigrant Visa (SIV) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfshirë familjet e tyre.
3. Mbrojtja e përshkruar në pikat paraprake, do të ofrohet në pajtim me procedurat e parapara në Ligjin Nr. 06/L-026 për Azil.
4. Personat subjekt të pikës 2. të këtij vendimi, do t'i nënshtrohen procesit të verifikimit nga institucionet relevante të sigurisë në Republikën e Kosovës, në rast të nevojës e në qëllim të sigurisë kombëtare, sipas vlerësimit të institucioneve relevante në Republikën e Kosovës.
5. Mbrojtja e ofruar nga institucionet e Republikës së Kosovës nuk do të paragjykojë njohjen e statusit të refugjatit apo mbrojtjes plotësuese, në rast që personat subjekt të pikës 2. të këtij vendimi, kërkojnë një mbrojtje të tillë.
6. Personat nga pika 2. e këtij vendimi, gjatë kohës së qëndrimit në Republikën e Kosovës, do të veprojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe do të gëzojnë të drejtat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
7. Ministria e Punëve të Brendshme do të bëjë vlerësim në vazhdimësi të gjendjes, dhe atëherë kur për një gjë të tillë lind nevoja, do të ndërmerr masa të caktuara lidhur me menaxhimin e situatës, përfshirë këtu kufizimin potencial të lëvizjes së personave nga pika 2. e këtij vendimi.
8. Për çështje që nuk janë të rregulluara me Ligjin Nr. 06/L-026 për Azil ose me këtë vendim, autorizohet Ministri i Punëve të Brendshme të nxjerr vendime.
9. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme të fillojë përgatitjet e duhura me qëllim të realizimit të mbrojtjes së përkohshme dhe bashkërendimin e këtij procesi.
10. Obligohen institucionet relevante të bashkëpunojnë me Ministrinë e Punëve të Brendshme gjatë zhvillimit të procesit të ofrimit të mbrojtjes së përkohshme.

11. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë